KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE

KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

PAKOJA FISKALE EMERGJENTE

Analizë e shkurtër

PAKOJA FISKALE EMERGJENTE

Analizë e shkurtër

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit apo bartjes në asnjë formë, duke përfshirë edhe fotokopjimin apo sistem tjetr të ruajtjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jokomerciale. Cilido që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
Email: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autor: KDI

Faqosja dhe dizajni: envinion

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës – Transparency International Kosova dhe përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e Programit "Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies publike në kohën e pandemisë Covid-19".

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive 6
Rekomandimet 7
Pakoja emergjente fiskale 8
Masa e tretë e pakos emergjente fiskale 11
Masa e dhjetë e pakos emergjente fiskale 11
Shkalla e realizimit të pakos emergjente fiskale 12
Realizimi i masës së tretë të pakos 12
Realizimi i masës së dhjetë të pakos 13
Realizimi i përgjithshëm i pakos 14
Sfidat gjatë zbatimit të pakos 16
Kosova dhe rajoni 18
Parashikimet për recesionin ekonomik 22
Pakoja për Rimëkëmbjen Ekonomike 24

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo analizë është pjesë e projektit të Institutit Demokratik të Kosovës "Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies publike në kohën e pandemisë Covid-19" i financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Projekti ka për qëllim të monitorojë procesin e zbatimit të masave 3 dhe 10 në kuadër të pakos emergjente fiskale nga institucionet e Kosovës, më saktësisht të monitorojë dhe vlerësojë përmbushjen e zbatimit të masave të cilat ndërlidhen me mbështetjen financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre dhe likuiditetin financiar te kompanive publike dhe private si dhe të ofrojë rekomandime përkatëse.[1]

Qeveria e Republikës së Kosovës, sikurse shumica e qeverive në botë të ndodhura përballë një emergjence të tillë të përmasave globale, u detyrua të rishikojë buxhetin në mënyrë që të sigurojë mjete financiare për zbatimin e masave të jashtëzakonshme. Pako me masa të ngjajshme po zbatohen në një kohë kur mbikëqyrja parlamentare është dukshëm e limituar për shkak të kufizimeve të lidhura me rrezikun për shëndetin publik.

Mësimet e nxjerra këtyre pesë muajve të fundit tregojnë se në kushte të tilla rritet rreziku për keqpërdorim të fondeve të destinuara për mbështetje ekonomike dhe kujdes shëndetësor. Instituti vlerëson se rreziqet nga korrupsioni në kohë pandemie duhet të adresohen si gjatë së dizajnimit ashtu edhe gjatë zbatimit të programeve përmes aplikimit të rregullave të transparencës dhe llogaridhënies, me theks të veçantë në mekanizmat gjatë shpërndarjes së fondeve.

Transparenca gjatë procesit vendimmarrës është e domosdoshme për shkak të rrezikut në rritje të kapjes ose shtrembërimit të tij nga grupe të ndryshme të interesave për përfitime të tyre. Këto rreziqe mund të përfshijnë devijime të qëllimshme gjatë financimit të sektorit të shëndetësisë si dhe hartimin e pakove që favorizojnë sektorët industrialë dhe kompanitë me lobistët më të fuqishëm e në dëm të sektorëve më pak të afërta me vendimmarrësit.

1 Për një analizë të KDI-së rreth pakos fiskale shih: "Përfitimet e punëtorëve nga pakoja emergjente", KDI, Prill 2020 http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/05/P%C3%ABrfitimet-e-pun%C3%ABtor%C3%ABve-nga-pakoja-emergjente.pdf

REKOMANDIMET

1. Qeveria dhe Kuvendi të mobilizojnë të gjitha kapacitetet e tyre në mënyrë që të sigurohet realizimi i plotë i pakos emergjente fiskale.

2. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet fillimit të zbatimit të masës 10 të kësaj pakoje e cila synon të sigurojë likuiditet financiar për mikro-ndërmarrjet dhe të vetpunësuarit.

3. Të nënshkruhet marrëveshja e mirëkuptimit mes Ministrisë së Financave dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore si hap i parë i realizimit të masës 10. Kompanitë vendore kanë nevojë imediate për qasje të lehtë në financa me qëllim të mirëmbajtjes së kapaciteteve të tyre të prodhimit dhe përmbushjes së kërkesave të tregut.

4. Një sinergji më e madhe mes Qeverisë dhe Odave Ekonomike duhet të sigurojë adresimin e nevojave të shumta të komunitetit të biznesit. Odat ekonomike, si akterë shumë të rëndësishëm në këtë mes me një qasje më proaktive do të ishin ndihmesë e pazëvendësueshme pasi që posedojnë informata më të sakta dhe më të detajuara rreth gjendjes aktuale dhe nevojave të bizneseve.

5. Një vërejtje e ekonomistëve për pakon emergjente fiskale ka qenë procedurat burokratike gjatë procesit të aplikimit e cila ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të aplikacioneve dhe rritjen e numrit të aplikacioneve të pavlefshme. Në fazat e ardhshme, Qeveria duhet të lehtësojë procedurat duke pasur kujdes që të mos ndikoj në rregullsinë e përgjithshme të procesit të aplikimit.

6. Për shkak të rrezikut në rritje nga keqpërdorimi i fondeve të dedikuar për mbështetje ekonomike dhe kujdes shëndetësor, KDI rekomandon institucionet që këto rreziqe të adresohen si gjatë dizajnimit ashtu edhe gjatë zbatimit të pakove duke aplikuar rregulla të qarta të transparencës dhe llogaridhënies. Një prej këtyre mekanizmave do të duhej të parashihte edhe kanale më të lehta komunikimi mes institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe publikut në mënyrë që informatat e përditësuara zyrtare të jenë lehtë të qasshme.

7. Pakoja e ardhshme, ajo për rimëkëmbje ekonomike, duhet të jetë shumëfish më e madhe se pakoja e parë dhe duhet të parasheh edhe mundësinë e vazhdimit të disa prej masave nga pakoja emergjente fiskale për muajtë korrik, gusht dhe shtator me qëllim të përshpejtimit të rimëkëmbjes së sektorit privat si promotor kryesor i zhvillimit ekonomik në Kosovë.

8. Në sigurimin e fondeve, Qeveria duhet të luajë rol më proaktiv dhe të fokusohet në ato institucione financiare ndërkombëtare (si FMN dhe BB) që kanë mobilizuar shuma të mëdha për t'u dalë në ndihmë vendeve në nevojë.

9. Pakoja e rimëkëmbjes të parasheh masa konktete dhe politika të qarta për sektorët me potencial: sektori i teknologjisë informative, përfshirjen e "agjendës së gjelbër" në rimëkëmbjen ekonomike si dhe eskplorimin e trendi të ri – përpjekje e korporatave për transferimin e linjave të tyre të veçanta nga Azia në rajonin tonë.

10. Qeveria duhet të parasheh lehtësira më të mëdha për ato biznese ku pronar është gruaja si mundësi për fuqizimin e mëtejmë të gruas në shoqërinë kosovare.

PAKOJA EMERGJENTE FISKALE

Më 11 mars 2020, dy ditë para verifikimit të rastit të parë me Covid-19 në Kosovë, filloi zbatimi i masave shtrënguese[2] të cilat, mes tjerash, përfshinin edhe ndërprerjen e menjëhershme të procesit edukativo-arsimor në Kosovë dhe një seri masash tjera. Dy ditë më vonë, këto masa u plotësuan me reduktimin dhe mbylljen e të gjitha veprimtarive me përjashtim të atyre që konsideroheshin vitale për shoqërinë.[3] Vendimi ndalonte veprimtaritë e disa bizneseve me qëllim të shmangies së përhapjes së virusit tek qytetarët. Madje u aplikua edhe karantinimi lokal duke ndaluar qarkullimin e qytetarëve në disa komuna më të prekura nga Covid-19.

Qëllimi kryesor i masave kufizuese ishte që të mos sfidoheshin kapacitetet ekzistuese shendetesore të shtetit në mënyrë që mjeku kosovar të mos vihet para situatave dhe dilemave morale kur duhet të vendosë se kush do të futet në aparatet e respiratorëve dhe do të jetojë e kush jo - situata me të cilat u ballafaquan kolegët e tyre italianë dhe spanjollë.[4]

Gjersa kriza shëndetësore vazhdon edhe sot e kësaj dite, debati mes vendimarrësve dhe komunitetit afarist rreth aspektit ekonomik të krizës dhe masat që mund të merren në zbutjen e efekteve të saj sa vijnë e intensifikohen. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) i cili vazhdimisht "mat pulsin" e ekonomisë dhe financave botërore, njoftoi se bota po përballet me një krize ekonomike të paparë më herët. "Asnjëherë në historinë e FMN-së ekonomia botërore nuk është përballë me një ngërç të tillë" tha kryetarja e FMN-së, Kristalina Georgieva dhe njoftoi se kanë vënë në dispozicion tërë kapacitetin financiar prej 1 trilion dollarësh për vendet e prekura nga koronavirusi[5].

Si pasojë e pandemisë por edhe e masave të ndërmarra për parandalimin e saj, shumë kosovarë humbën vendet e tyre të punës. Instituti GAP në raportin "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës" thotë se vetëm në muajin prill 2020 janë regjistruar 32,377 punëkërkues të rinj.

E gjendur para një situate të mbylljes pothuajse të plotë Qeveria e Kosovës, më 30 Mars 2020, mori vendim për aprovimin e Pakos Emergjente Fiskale[6] me 15 masa në vlerë prej rreth 179.65 milionë eurosh me qëllim të adresimit të nevojave imediate të krjiuara në vend gjatë pandemisë Covid-19. Këto mjete janë ndarë për të subvencionuar sektorin privat (përfshirë punëtorët), për të ndihmuar përfituesit e skemave sociale dhe ndërmarrjet publike, komunat e Kosovës, komunitetet pakicë, punëtorët e sektorit publik në vijën e parë të frontit dhe për të ndihmuar prodhimin bujqësor në mënyre që të tejkalohet gjendja e tyre e vështirë.

2 "Vendimi i mbledhjes së 7-të Qeverisë së Republikës së Kosovës", Qeveria e Kosovës, Nr. 01/07, 11 mars 2020, e qasshme në https://bit.ly/2ThYrQt

3 "Vendim për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve me Corona Virus Covid-19", Nr. 01/09, 13 mars 2020, e qasshme në https://bit.ly/2X5CUvw

4 "Raka: Vala e dytë e koronavirusit, e pashmangshme", Koha.net, 5 maj 2020.

5 "World Economic Outlook, Chapter 1 - The great lockdown", Prill 2020

6 Ibid

MASA	PËRSHKRIM I SHKURTËR	BUXHETI
Masa 1	Pagesë të dyfishtë të vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit të skemave sociale për muajtë mars, prill dhe maj.	7,650,000.00 €
Masa 2	Pagesë shtesë prej 30 € në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ultë se 100 € për muajtë prill, maj dhe qershor.	13,000,000.00 €
Masa 3	Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të krizës së pandemisë. a) Paga mujore të punonjësve në vlerë prej 170 € për muajin prill dhe maj b) Subvencionimi i qirasë deri në 50% të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për muajin prill dhe maj c) Vlera e kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin prill dhe maj	61,000,000.00 €
Masa 4	Huadhënie pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020	20,000,000.00 €
Masa 5	Mbështetje shtesë financiare për Komunat e Republikës së Kosovës që janë ndikuar nga përballja me pandeminë.	10,000,000.00 €
Masa 6	Shtesë mbi pagë në vlerë prej 300 € për punëtorët në terren që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në vendin e tyre të punës për muajin prill dhe maj.	15,000,000.00 €
Masa 7	Pagesë shtesë në vlerë prej 100 € për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive për majin prill dhe maj.	3,000,000.00 €

Masa 8	Asistencë mujore në vlerë prej 130 € për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajin prill, maj dhe qershor.	**4,000,000.00 €**
Masa 9	Mbështetje për iniciativat dhe projektet që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo-shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik.	**2,000,000.00 €**
Masa 10	Sigurimi i likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit. Qeveria ka paraparë që nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garantimin Kreditor të Kosovës të ofroj shumën prej 10,000 € euro për periudhën 24 mujore.	**15,000,000.00 €**
Masa 11	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor.	**5,000,000.00 €**
Masa 12	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore.	**5,000,000.00 €**
Masa 13	Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik,	**10,000,000.00 €**
Masa 14	Mbështetje për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, me 130€ për dy muajt pasues pas regjistrimit.	**6,000,000.00 €**
Masa 15	Asistencë mujore në vlerë prej 130 € për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajin prill, maj dhe qershor.	**3,000,000.00 €**

TABELA 1 Pakoja emergjente fiskale e Qeverisë së Kosovës

3 Masa e tretë e pakos emergjente fiskale

Masa e tretë ofronte mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik. Sipas MFT-së, synim kryesor ishte mbrojtja e bizneseve dhe punëtorëve të tyre që në mënyrë direkte apo indirekte nuk kanë punuar për shkak të ndalesave që Qeveria i ka imponuar me qëllim të parandalimit të pandemisë. Qeveria kishte për synim të parandalojë bizneset që të shkëpusin kontratat derisa janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi. Qeveria ka marrë përsipër edhe kontributet e tyre që e ka ngritur koston në €182.89 për çdo punëtor.

10 Masa e dhjetë e pakos emergjente fiskale

Edhe pse e vlerësuar si pako kryesisht e natyrës sociale, pakoja emergjente fiskale megjithatë ofronte mundësi të shumta për ndërmarrjet. Rreth gjysma e shumës së përgjithshme të pakos ndërlidhet me veprimtaritë afariste në Kosovë. Masa e dhjetë synon të sigurojë likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit. Qeveria kishte paraparë që nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garantimin Kreditor të Kosovës (FGKK) të ofroj kredi në shumën prej dhjetë mijë (10,000 €) euro për periudhën 24 muajshe. Buxheti për këtë masë kap shumën prej pesëmbëdhjetë milionë (15,000,000.00 €) euro. Kjo masë përfshinte edhe Shoqëritë Tregtare/ Kompanitë e autorizuara që ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike) me kthim deri më 31.12.2020, në kuadër të vlerës së përcaktuar te masa e katërt e kësaj pakoje.

Në rast të aprovimit të financimit, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të ofrojë garanci deri në 50% të shumës së krediturar, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës do të mbulojë garancinë shtesë deri në 30% të shumës së krediturar mbi shumën e garantuar nga FKGK. Për këto ndërmarrje do të subvencionohen edhe normat e interesit, pra do të jenë kredi me interes zero për qind. Memorandumi midis Ministrisë së Financave dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore nuk është nënshkruar ende.

SHKALLA E REALIZIMIT TË PAKOS EMERGJENTE FISKALE

3 Realizimi i masës së tretë të pakos

MFT ka njoftuar se deri në datën 15 maj 2020 janë pranuar 33,887 aplikacione për 152,245 punëtorë për masën 3.a. prej të cilave janë aprovuar 108,095 punëtorë. Sipas planit operacional për zbatimin e pakos emergjente fiskale, për të përfituar nga masa 3.a. (shpenzimet e pagave mujore të punonjësve), punëdhënësi ishte i obliguar që deri më 15 maj 2020 të plotësojë dhe ngarkojë formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK përmes sistemit elektronik EDI. Punëdhënësi gjithashtu duhej të ofronte dëshmi se veprimtaria e tij është ndikuar direkt apo indirekt nga situata e emergjencës shëndetësore. Këtë ai mund t'a bënte duke ofruar dëshmi se vepron me njërin nga kodet e veprimtarive në Aneksin A të Planit Operacional[7] të cilave u është ndërprerë puna me urdhëresë të Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS). Rënien e të hyrave të tyre punëdhënësit mund t'a dëshmonin edhe përmes librit të arkës, bilancit bankar apo dëshmive të tjera të ngjajshme. I punësuari duhej të deklarohej si primar në listëpagesën mujore të punëdhënësit, për periudhën shkurt 2020 dhe të posedojë llogari bankare valide.

ATK-ja më 19 prill 2020 kishte publikuar edhe doracakët me udhëzime shtesë dhe detaje të mjaftueshme se si bëhet dorëzimi i aplikacionit, plotësimi i formularit dhe dokumentet shtesë për masat 3.a. dhe 3.b.

Meqë ishin pranuar shumë aplikacione me gabime, ATK-ja krijoi një aplikacion shtesë për korrigjimin e gabimeve dhe shtyrjen e afatit për dërgimin e korrigjimeve deri më 24 maj. Kjo ka ndikuar që edhe Komisioni i përbashkët, i themeluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe MEPTINIS, për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga punëdhënësit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, të vazhdoj të punoj deri në shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve. Lista e të punësuarve të cilëve ju është aprovuar kërkesa për të përfituar nga kjo pikë, është dërguar nga Komisioni në Thesar, për t'u siguruar se i punësuari përfiton vetëm një herë brenda një skeme gjatë një periudhe mujore.

Për **masën 3.b**. i cili subvencononte qiranë deri në pesëdhjetë (50%) të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ngjajshëm me masë 3.a., qiramarrësi ishte i detyruar që përmes sistemit elektronik EDI të plotësoj dhe ngarkoj formularin dhe listën e dizajnuar nga ATK. Si dëshmi, qiramarrësi duhej të ngarkonte kontratën e qirasë në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit të lidhur para datës 1 Mars 2020. Kërkesat e qiramarrësve, janë shqyrtuar nga Komisioni i përbashkët i themeluar nga ATK dhe MEPTINIS, brrnfs pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune nga data e parashtrimit të kërkesës. Lista e qiradhënësve të cilëve ju është aprovuar kërkesa është dërguar nga Komisioni në Thesar i cili në konsultim me ATK ka siguar se do të ndalë tatimin në burim prej nëntë për qind (9%), në momentin e pagesës së këtij subvencioni.

Masa 3.c. parashihte që personave të cilët përfitojnë nga masa 3.a. të ju mbulohen edhe kontributet pensionale në emër të punëdhënësit dhe të punësuarit dhe obligimi tatimor me qëllim që i punësuari të marrë pagën neto prej 170 euro.

Qeveria e Kosovës në pakon emergjente tek pjesa e biznesve ka përfshirë tre kategori të punëtorëve që janë prekur apo dëmtuar nga mbyllja e biznesveve ku kanë punuar apo nga mungesa e të hyrave për ato biznese. Tabela në vijim ofron përshkrimin e secilës kategori.

7 Po aty

Kategoria A	Punëtorët e rregullt, të cilët mbështeten me 170 euro për dy muaj
Kategoria B	Punëtorët e rregullt e të cilët janë larguar nga puna gjatë pandemisë, të cilët mbështetën me 130 euro për tre muaj
Kategoria C	Punëtorët që janë paguar me "para në dorë" e që biznesi privat i ka deklaruar si punëtor të ri u mbështeten me 130 euro për dy muaj pas regjistrimit.

TABELA 2 Kategorizimi i punëtorëve sipas pakos emergjente fiskale

Sipas Administratës tatimore të Kosovës (ATK), deri më 17 korrik 2020, numri final i punëtorëve përfitues sipas kategorive është si në vijim:

Kategoria A	Kategoria B	Kategoria C	Me rrezik[8]	TOTAL
160,935	1,562	15,323	18,229	196,049

TABELA 3 Numri i punëtorëve përfitues të pakos emergjente fiskale

3 Realizimi i masës së dhjetë të pakos

Aplikimet për masën 10 kanë filluar kah mesi i muajit maj kur edhe janë përmbyllur punët përgatitore. Më 15 maj MEPTINIS njoftoi[9] të gjitha Ndërmarrjet Private që ofrojnë shërbime publike nëpër institucione dhe komuna për mundësinë për të aplikuar për huamarrje nga masa 10.2 e Pakos Fiskale Emergjente. Nga kjo masë mund të përfitojnë ndërmarrjet private që ofrojnë shërbime publike dhe që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik. Me qëllim të sigurimit të likuiditetit për të përballuar shpenzimet operative, ndërmarrjeve u ofrohet huamarrje pa interes, me kthim deri më 31.12.2020.

Më tutje, Ministria njoftonte ndërmarrjet se për të aplikuar duhet të përgatisin dokumentet si aplikacionin (që shkarkohet nga faqja zyrtare e MEPTINIS-it), bilancin e gjendjes për tre vitet e fundit, pasqyrën e të ardhurave për tre vitet e fundit, rrjedhën e parasë së gatshme ("cash flow") për tre vitet e fundit, planifikimet buxhetore për të hyrat dhe shpenzimet për vitet 2018, 2019, 2020, listën e të punësuarve dhe pagat, kartelën e parave të gatshme (cash card) dhe linjat buxhetore të parave të gatshme (arkën, gjendjet bankare, letrat me vlerë të tregtueshme në para), të hyrat mujore të realizuara për secilin muaj të vitit 2020, shpenzimet operative të realizuara për secilin muaj të vitit 2020, shpenzimet si pasojë e situatës me COVID-19.

Kriteret bazë janë përcaktuar tanimë, kurse kushtet specifike do të publikohen nga institucioni përgjegjës i zbatimit të masës, gjegjësisht Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Sipas masës 10, shuma totale për kreditë prej 10 mijë eurosh është 15 milion euro, që i bie se deri 1,500 ndërmarrje mund të përfitojnë nga kjo masë. Ky numër mund të jetë edhe më i madh nëse llogarisim se kompanitë mund të aplikojnë për shuma edhe më të vogla. Qeveria tërhoqi vërejtjen aplikuesve se kjo masë nuk eshte dizajnuar për t'i adresuar problemet shumëvjeçare të grumbulluara në ndërmarrjet e tilla, por të siguroj vazhdimësi të aktiviteteve të tyre afariste.

8 Punëtorët në terren që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në vendin e tyre të punës kanë përfituar nga 300 euro nga masa 6 e pakos.

9 https://meptinis.rks-gov.net/Page.aspx?id=1%2C3%2C934&fbclid=IwAR33wwG9PDcbTmQwfQJF2I_HdKQILq_uddiiBYEEQ2BOQYDL5KcUciQDuQ4

Realizimi i përgjithshëm i pakos

Deri më 17 korrik, Qeveria e Kosovës ka realizuar vetëm 45 për qind të shumës totale të pakos. Tabela në vijim ofron të dhëna për secilën masë individualisht:

MASA		"BUXHETI I PARAPARË" / TË SHPENZUARA	"PËRQINDJA E REALIZIMIT"
Masa 1	Pagesë e dyfishtë e skemës sociale për të gjithë përfituesit	7,650,000 / 7,818,454	102%
Masa 2	Pagesa shtese prej 30 € për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale me më pak se 100 euro	13,000,000 / 16,322,903	126%
Masa 3	Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare në vështirësi	61,000,000 / 25,474,597	42%
Masa 4	Huadhenie pa interes per ndermarrjet publike në vështirësi	20,000,000 / 10,082,599	50%
Masa 5	Mbështetje shtesë financiare për komuna	10,000,000 /	0%
Masa 6	Shtesës mbi pagë në vlerë prej 300 € për punëtorët në terren	15,000,000 / 14,787,285	99%
Masa 7	Pagesë shtesë në vlerë prej 100 € për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive	3,000,000 / 1,272,468	42%
Masa 8	Asistencë mujore prej 130 € € për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës	4,000,000 / 101,660	3%
Masa 9	Mbështetje për iniciativat dhe projektet që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo-shumicë	2,000,000 /	0%

MASA		"BUXHETI I PARAPARË" / TË SHPENZUARA	"PËRQINDJA E REALIZIMIT"
Masa 10	Sigurimi i likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit	15,000,000	0%
Masa 11	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë	5,000,000	0%
Masa 12	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	5,000,000	0%
Masa 13	Mbështetje për eksportuesit	10,000,000	0%
Masa 14	Mbështetje për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku një vjeçare	6,000,000 1,830,131	31%
Masa 15	Asistencë mujore në vlerë prej 130 € për qytetarët me kushte të rënda sociale	3,000,000 2,713,880	90%

TABELA 4 Shkalla e realizimit të pakos emergjente fiskale[10]

Instituti e vlerëson shqetësuese faktin se mjetet financiare për disa nga masat e parapara, e të cilat paraqesin "boshtin kurrizor" të pakos emergjente, siç është Masa 10 (e cila synon sigurimin e likuiditetit financiar për mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit) nuk kanë filluar të shpërndahen edhe katër muaj pas miratimit të pakos. T'ua rikujtojmë lexuesit se Qeveria ka paraparë që me këto mjete të përkrahës shoqëritë tregtare të aplikojnë për financim nga bankat komerciale të Republikës së Kosovës me afat të maturitetit deri në 24 muaj. Me këtë rast, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të ofronte garanci deri në 50% të shumës së krediturar, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës do të mbulonte garancinë shtesë deri në 30% të shumës së krediturar mbi shumën e garantuar nga FKGK.

10 E-mail zyrtar nga Ministria e Financave pas kërkesës së KDI-së për qasje në dokumente zyrtare, datë 17 korrik 2020

SFIDAT GJATË ZBATIMIT TË PAKOS

Pakoja emergjente fiskale prej 180 milion eurosh ishte emergjente dhe si e tillë ishte më shumë në shërbim të zbutjes së rënies ekonomike sesa në tendencë mirëmbajtjen apo zhvillimin e sistemit aktual të ekonomisë. Masat e marra të Qeverisë ishin korrekte dhe humane, sepse me to u përfshinë ata që kontribuojnë dhe i janë ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut në luftën kundër pandemisë.

Është vlerësim i përgjithshëm se nasat nga pakoja emergjente si subvencionimi i pagave, kompenzimi 50 për qind i qirasë për biznese, subvencionimi i pagave të sektorit privat, shtyrja e deklarimeve tatimore, ndihmesa për familjet me asnje anëtarë të punësuar ishin mbështetje e vogël për fazën e parë, por në fazat e ardshshme lipset një dorë më e fortë ndihmëse nga shteti. Sidomos kërkohet një sinergji më e madhe mes Qeverisë dhe Odave Ekonomike që t'i adresojnë në mënyrë më thelbësore nevojat e shumta të komunitetit afarist. Odat Ekonomike janë akter i rëndësishëm në këtë mes, dhe prej tyre kërkohet një qasje më proaktive pasi që ato kanë informata të sakta dhe të detajuara mbi gjendjen dhe nevojat aktuale të bizneseve.

Procedurat e tepërta burokratike gjatë aplikimit. Një vërejtje e ekonomistëve rreth pakos emergjente fiskale ishin edhe procedurat e tepërta burokratike gjatë aplikimit për të përfituar e cila ka mundur të rezultojë në reduktimin e aplikacioneve dhe pranimin e numrit të madh të aplikacioneve të pavlefshme. Sidomos u kritikuar mënyra elektronike e aplikimit për një shtresë të popullsisë me njohuri të pakta në shfrytëzimin e teknologjisë informative.

Mospërfshirja e disa kategorive në pako. Gjatë ekzekutimit të pjesës së parë të shtesës në pagë prej 300 eurosh (masa 6 e pakos emergjente fiskale) për punëtorët në terren të ekspozuar drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit në punën e tyre (stafi mjekësor, policët, gardianet e Shërbimit Korrektues, zjarrfikësit, personeli i FSK-së, punëtorët në Karantinë - Qendra e Studentëve të Prishtinës, inspektorët e punës, inspektorët tatimor, doganierët, inspektorët e tregut, inspektorët komunalë etj.) u bë e dukshme mospërfshirja e disa kategorive të rëndësishme, siç ishte rasi i punëtorëve të kompanive për grumbullimin e mbeturinave. Këta punëtorë organizuan edhe greva simbolike në fillim të muajit maj duke kërkuar që të përfshihen në masën 6 të pakos emergjente si punëtorë terreni që u ekspozohen drejtpërdrejtë rrezikut të infektimit.[11] Gjithashtu palë të ndryshme u ankuan për mospërfshirjen e disa kategorive në këtë pako si familjet që varen nga remitencat të cilat për shkak të krizës globale janë ndërprerë apo reduktuar dukshëm, punëtorët pa kontrata dhe nënat vetëushqyese[12]

Aplikime nga bizneset/ndërmarrjet që kanë vazhduar të punojnë gjatë **pandemis**ë**.** Se ka pasur probleme gjatë implementimit e pranon edhe Ministri Bislimi i cili përmend disa biznese që kanë aplikuar e që nuk është dashtë të jenë pjesë e pakos (qoftë ndërmarrje publike apo ndërmarrje që kanë operuar më sukses gjatë kësaj faze). Si shembull ai përmendi disa kompani që merren me tregti më pakicë me mbi 1,100 punëtorë që i kanë futur të gjithë punëtorët në listën për aplikim. Të gjithë qytetarët e Kosovës e dijnë se pjesa më e madhe e këtyre bizneseve kanë operuar pa problem, bile kanë shënuar rritje të qarkullimit të mallrave si pasojë e gjendjes së psikozës kolektive për grumbullim të rezervave ushqimore për familjet e tyre.

MFT publikoi edhe një reagim zyrtar ndaj keqpërdoruesve potencial më 6 maj duke ua rikujtuar edhe një herë se Masa 3 e pakos emergjente fiskale synon mbështetjen e ndërmarrjeve vendore që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së aktivitetit të tyre për shkak të masave të ndër-

11 "Pastrimi protests exclusion from emergency package", Prishtina Insight, 14 maj 2020.

12 Kadaj-Bujupi: Në pakon Emergjente të përfshihen edhe nënat vetushqyese dhe punëtorët pa kontrata, Gazeta Blic https://gazetablic.com/kadaj-bujupi-ne-pakon-emergjente-te-qeverise-te-perfshihen-edhe-nenat-vetushqyese-dhe-punetoret-pa-kontrata/

marra me qëllim luftimin e pandemisë COVID 19 dhe assesi nuk nënkupton zëvendësim të obligimit privat për shlyerje të këtyre detyrimeve me atë publike në përgjithësi.[13] Në atë reagim u njoftua edhe për rastet kur ndërmarrjet kanë aplikuar gabimisht meqë nevojat e tyre është dashur të adresohen përmes masave tjera.

Në fund, Ministria e Financave dhe Transfereve pat njoftuar se nuk kanë të drejtë aplikimi

(1) Ndërmarrjet që operojnë në sektorët e tregtisë me pakicë (marketet ushqimore dhe supermarketet), farmacitë dhe furrat e bukës, nuk duhet të jenë pjesë e masës 3, meqë të njëjtat kanë operuar gjatë gjithë kohës.
(2) Shkollat dhe universitetet private nuk duhet të jenë në mesin e aplikantëve meqë të njëjtit kanë vazhduar edhe mësimin online, edhe arkëtimin e pagesave nga nxënësit dhe studentët e tyre.
(3) Ndërmarrjet prodhuese dhe tjera të cilat e kanë vazhduar veprimtarinë gjatë gjithë kohës kurse është dashur të aplikojnë vetëm në rastet kur një pjesë e punëtorëve nuk ka mundur të punojë si rezultat i masave kufizuese.
(4) Ndërmarrjet që ofrojnë shërbime për sektorin publik dhe janë kompensuar nga kontraktori nuk është dashur të jenë pjesë e masës së 3 meqë të njëjtat kanë operuar dhe janë kompensuar për shërbimet e ofruara.

Pagesat e ekzekutuara gabimisht për ndërmarrjet aktive. Në njoftimin e njëjtë, MFT pat tërhequr vërejtjen se secila ndërmarrje që e gjen veten në katër kategoritë e përshkruara më lartë do të konsiderohet se ka kryer mashtrim të institucioneve publike duke tentuar të përfitojë pa të drejtë. Si të tilla, këto ndërmarrje rekomandohet të tërheqin aplikimet e tyre menjëherë, dhe në rast se pagesat janë ekzekutuar, t'i kthejnë ato në arkën e shtetit.

Sipas përfaqësuesit të MFT-së , disa kompani tanimë i kanë kthyer mjetet me vullnet të tyre, dhe ka të tilla edhe që kanë tërhequr aplikacionet, pas vetëdijesimit të tyre, gjë të cilën e vlerësojmë si veprim të matur dhe e inkurajojmë edhe kompanitë tjera të cilat i përkasin kësaj kategorie.[14] E drejta e verifikimit "ex-post" (pas ngjarjes) vjen si rrjedhojë e pamundësisë të verifikimit më të saktë në kohë shumë të shkurtër, andaj me qëllimin e ekzekutimit më të shpejt, sepse ka punëtorë që kanë shumë nevojë për këto mjete financiare në këtë kohë pandemie, ka gabime që kanë mund të rrjedhin nga Komisioni, mirëpo këto raste do të verifikohen gjithsesi. MFT kishte premtuar se do të publikoj edhe listën e përfituesve të këtyre masave, por edhe të atyre që kanë tentuar të keqpërdorin masat.

4) Pagesat në xhirollogarinë e punëdhënësit e jo të punëtorit. Sa i përket masës 3, ka pasur zëra për keqpërdorime me pagat e punëtorëve të cilat kanë shkuar në konton e punëdhënësit e jo në atë të punëtorit. Këta punëdhënës nuk i kanë përcjellur këto mjete tek punëtorët dhe MFT ka reaguar për to, duke ofruar sqarime shtesë për punëdhënësit të cilët mund të kenë keqkuptuar masën, e cila nuk ka për qëllim të plotësoj fitimin e plotë të humbur të kompanisë apo të kompensoj të gjitha shpenzimet e kompanisë. "Mirëpo, me të drejtë ligjore ATK ka të drejtë të verifikojë rastet specifike edhe pas shqyrtimit dhe ekzekutimit të aplikacioneve, me ç 'rast natyrisht se pasojnë edhe kundërveprime në 'kthyerje të mjeteve dhe dënimeve potenciale për keqpërdorim", ka theksuar përfaqësuesi i MFT-së.[15]

5) Mungesa e procedurave të **ankimimit.** Problem tjetër e kemi parë edhe mungesën e procedurave të ankimimit, në rast të refuzimit të aplikacionit. Instituti e ka ngritur këtë shqetësim gjatë intervistës me Zëvendësministrin për Financa dhe Transfere, i cili e pranoi se MFT nuk e kishte paraparë fare këtë si mundësi.

6) Pagesa të ekzekutuara me vonesë. Edhe pse Pakoja Emergjente është miratuar në fund të muajit mars, pagesat janë vonuar deri në muajin maj. Sipas MFT-së kjo ka ndodhur ngaqë janë plotësuar aplikimet gabimisht.[16]

13 "Reagim dhe vetëdijësim ndaj keqpërdoruesve potencial", komunikatë për shtyp, Ministria e Financave dhe Transfereve
14 Intervistë me Ilir Aliu, zëvendësministrin e MFT-së, datë 15 maj 2020
15 Ibid
16 https://telegrafi.com/pagesa-e-punetoreve-nga-pakoja-emergjente-ministria-e-ekonomise-pronaret-aplikuan-llogari-te-bizneseve/

KOSOVA DHE RAJONI

Ballkani Perëndimor, krahasuar me pjesën tjetër të kontinentit, u prek më vonë nga Covid-19. Një ndër arsyet kryesore ishte se shtetet e rajonit morrën masa të mënjëhershme të mbylljes së jetës publike, kufinjëve dhe bizneseve edhe para se të shënohen rastet e para. Kjo do të thotë që përkundër numrit më të vogël të rasteve, në muajt mars dhe prill, shumëçka mbeti e mbyllur, me ndalim qarkullimi për qytetarët dhe për pjesën dërrmuese të bizneseve. Edhe pakot emergjente fiskale që u miratuan nga qeveritë në rajon ishin dizajnuar në atë mënyrë që synonin stabilitet ekonomik në periudhën ku gjithçka është e mbyllur. Në tabelën në vijim kemi paraqitur një pasqyrë të përgjithshme të masave që u ndërmorren në shtetet e Ballkanit Perendimor:

Vendi	Disa nga masat kryesore fiskale
Kosova	Ndarja e 6 milion eurove për ministrinë e shëndetësisë Shtyerja e pagesave për tatim në të hyra Shtyerja e pagesës së kredisë Shtesa te dyfishtë për muajt prill dhe maj për familjet me asistence sociale Heqja e TVSH-sw për importet e miellit dhe grurit Pagesat e rrogave minimale për kompanitë e prekura, shtesa për të papunësuarit Fondi Zhvillimor per likuiditetin e ndermarrjeve (Masa 10)
Maqedonia e Veriut	Subvencionimi i kontributeve sociale për firma, shtyerje e tatimit në pagë për korporatat dhe asistencë financiare nga banka zhvillimore. Fonde nga Banka Zhvillimore. Pagë minimale për kompanitë e prekura nga mbyllja ekonomike Mbështetje financiare për punëtor që ishin pjesë e ekonomisë jo-formale Monitorim i çmimeve për produkte themelore, ilaçe, produkte dezinfektuese, heqje e taksës importuese për furnizime mjekësore.
Mali i Zi	Shtyerje e pagesës së tatimit në të ardhura dhe kontributeve sociale, Krijimi i Fondit Zhvillimor për sigurimin e likuiditetit Shtyerjen e pagesës së qerasë për patundshmëritë publike Parapagim për kontraktorë të projekteve kapitale Shtesa nga 50 euro për pensioner me të hyra të ulta. të tjerë me asistencë sociale dhe të papunët. Pagesa 70% të pagës minimale për punëtorët e bizneseve të mesme (SME)

Serbia	Rritje 10% të pagave të sektorit shëndetësor Një pagesë për të gjithë pensioneret 100 euro për të gjithë qytetarët Shtyerje e pagesës për kontribute sociale dhe tatime për tre muaj, që do të paguhen nga viti 2021 Pagë minimale për kompanitë e mesme të prekura për tre muaj, ndërsa 50% të pagës për kompanitë e mëdha. Moratorium 3 mujor në zbatimin dhe normën e interesit në borxhin tatimor.
Shqipëria	Fonde shtesë për sektorin e shëndetësisë, 3.5 miliardë Lek Pagë minimale biznese të vogla të prekura Dyfishimi i asistencës sociale për të papunësuarit dhe atyre që mirrnin ndihmë sociale Fond Sovran për Garanci, që bizneset të kenë qasje në overdrafte për të paguar punëtoret e tyre për tre muajt e ardhshëm me normë interesi 2.85% Një shumë 40 mijë Lek për punëtorë të pushuar nga puna Kredite për sektorin e turizmit dhe kompanitë eksportuese
Bosnja dhe Hercegovina	Pagesë minimale për punësuarit në sektorët e mbyllur Subvencionimi i kontributeve sociale dhe taksave për kompanitë Fond Garantues në Bankën Zhvillimore për të siguruar likuiditet Skemë e Garantimit të Kreditit Ndarja e fondeve nga Ministria e Bujqësisë për të nxitur rritjen e prodhimit

TABELA 5 Disa nga masat kryesore fiskale në vendet në rajon[17]

Në pyetjen se si krahasohen masat e Qeverisë së Kosovës me masat e Qeverive në rajon, MFT-ja ka theksuar se kanë marrë nota të larta nga institucionet ndërkombëtare financiare që ka rezultuar edhe me përkrahja e tyre të madhe. "Analizat e bëra nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare tregojnë se pakoja emergjente është optimale duke marr parasysh kufizimet që paraqiten nga problemet e trashëguara me buxhetin. Nëse krahasohet si përqindje në Bruto Prodhimin Vendor (BPV) me shtetet në rajon, del që Republika e Kosovës me 2.8% të BPV-së ka shpenzuar më shumë se vendet tjera në rajon për pakon emergjente fiskale", ka theksuar përfaqësuesi i MFT-së.

Instituti pas një analize krahasimore të pakove të ngjajshme në rajon ka gjetur se megjithatë është Serbia shteti me pjesëmarrjen më të lartë të shumës totale të pakos në BPV-së me 6.7 për qind. Në tabelen e mëposhtme kemi renditur masat e vendeve fqinje, pra masat që përfshijnë pagesat mujore, kontributet sociale/ pensionale si dhe garantimi i likuiditetit të bizneseve.

17 "Policy responses to Covid-19", Fondi Monetar Ndërkombëtar, e qasshme në https://bit.ly/3bHQMS3 , u qas nga KDI më 17 maj 2020.
" COVID-19 crisis response in South East European economies (as of April 15th)", OSBE, e qasshme në https://bit.ly/36bgtsX , u qas nga KDI më 17 maj 2020.

	SHUMA E PAKOS FINANCIARE (22.4.2020)	PAGA MUJORE	KONTRIBUTE PENSIONALE	LIKUIDITET
Kosova	190 milion euro (2.8% e BPV-së)	Pagë minimale për punëtor nga bizneset e prekura	Kontributet pensionale prill-maj 2020	10 mijë euro (norma e interest 0%), subvencionim 80%
Maqedonia e Veriut	200 milion euro (2.0% të BPV-së)	Pagë minimale për bizneset e prekura	Kontributet dhe sigurimet sociale për prill-qershor 2020	Asistencë firmave nga Banka Zhvillimore (norma e interesit 0)
Mali i Zi	75 milion euro (1% e BPV-së)	70% e pagës për punëtorët e biznesëve të mbyllura	Shtyerje e pagesës për kontribute sociale	Investment Development Fund (IRF) kredit për ndërmarrës me normë interesi 1.5%
Serbia	3.2 miliard euro (6.7% të BPV-së)	100 euro për çdo qytetarë mbi 18 vjeç Subvencion i pagave për SME (ndërmarrje të mesme) dhe ndërmarrësit për tre muaj. 50% e pagës minimale për kompani të mëdha të sektorit privat	Shtyerje kohore 3 muaj për kontribute pensionale dhe sociale	Skeme Garantuese me kredi për likuiditet me normë interesi prej 2.5% deri në 3%.
Shqipëria	400 milion euro (2.4% të BPV-së)	Pagë minimale për bizneset e prekura	Shtyerje e pagesave	Overdraft me interes 2.85
Bosnja dhe Hercegovina	50 milion KM (0.15% të BPV-së)	Pagë minimale për një muaj për punëtorët	Subvencionim i kontributeve	Fond Garantues me normën e interesit zero.

TABELA 6 Masat e ndërmarra në vendet fqinje

Në kuadër të Masës 3 dhe 10, Qeveria e Kosovës siguroi paga minimale 170 euro për punëtorët e biznesëve të prekura, subvencion të qirasë deri në 50% dhe mbulim i vlerës së kontributeve pensionale për muajt Prill dhe Maj 2020.

Maqedonia e Veriut subvencionoi kontributet dhe sigurimet sociale për firmat për tre muaj nga prilli deri në qershor 2020, pra një muaj më shumë se Kosova. Ngjashëm si Kosova paga minimale e vendit do të iu sigurohet bizneseve nga shteti që t'i mbajnë punëtorët e tyre.

Shqipëria kishte ofruar pagë minimale për bizneset e prekura, si dhe overdraft me interes 2.85 dhe maturitet deri në dy vite që të ua mundësojë kompanive të paguajnë punëtorët e tyre deri në tre muaj. Një pagesë për punëtorët e pushuar nga puna, atyre të sektorit turistik si dhe kompanive aktive eksportuese.

Mali i Zi ishte më dorështrenguar sa i përket subvencioneve, tek punëtoret dhe bizneset. Vetëm 70% e pagës minimale paguhej nga shteti, si dhe kontributet sociale nuk u mbuluan nga shteti por vetëm u shtyen për një kohë. Sa i përket likuiditetit të ndërmarrjeve, Mali i Zi formoj Fondin e Investimeve Zhvillimore me 120 milion euro për të siguruar kredite për bizneset me normë interesi 1.5%.

Serbia ka shpenzuar më së shumti në rajon duke i ndarë para çdo qytetari mbi 18 vjeç, siguruan pagë minimale për bizneset e prekura, shtyerje të pagesës për kontribute sociale dhe kredite me normë interesi 2.5% - 3%.

Bosnja dhe Hercegovina siguroi pagë minimale bizneseve vetëm për një muaj, subvencionoi kontributet si dhe ofroi kredi me zero interes.

Sa i përket shumës së pakove financiare më së shumti për ekonominë ka ndarë Serbia, e Kosova dhe Shqipëria i takojnë grupit të mesëm, ndërsa më së paku kanë ndarë Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Sa i përket masave që i kontrollojmë ne, Serbia ka dhënë 100 euro cdo qytetari mbi 18 vjec, çdo vend tjetër ka paguar vetëm pagat minimale për punëtorët në sektorët e prekur, përveç Malit të Zi ka paguar vetëm 70% të pagës. Sa i përket sigurimit të likuiditetit të ndërmarrjeve, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Bosnia & Hercegovina ofruan bizneseve kredi me normë interesi zero, ndërsa Mali i Zi (1.5%), Serbia (2.5%-3%) dhe Shqipëria (2.85%) ofruan kredi për ndërmarrje me një normë interesi.

PARASHIKIMET PËR RECESIONIN EKONOMIK

Ekonomia globale tanimë po kalon nëpër recesion ekonomik për shkak të pandemisë Covid-19. FMN parashikon rënie prej 5% në vitin 2020[18] kurse Banka Botërore jep dy skenarë të mundshëm për vendet e Ballkanit. Një skenar optimist parasheh që masat kufizuese mund të hiqen të tërat deri në fund të qershorit e në pjesën tjetër të vitit të filloj rimëkëmbja e ngadaltë ekonomike, ndërsa skenari më pesimist parasheh heqjen e masave në fund të gushtit.

Sipas Bankës Botërore Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi pritet të goditën me mbi 8% rënie të aktivitetit ekonomike meqë ekonomitë e tyre janë më të varura nga ofrimi i shërbimeve. Ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia do të zgogëlohën me më pak, 3.2%, 2.5% dhe 1.4% respektivisht.[19]

Të gjitha institucionet për vitin 2020 presin një rënie të aktivitetit ekonomik si rezultat i masave të ndërmarra për parandalimin e COVID-19, për t'u ndjekur nga një rimëkëmbje e shpejtë në 2021. MFT vlerëson se është ende herët të jepet bilanci përfundimtar i demit të shkaktuar nga pandemia. "Pritjet e MFT-së janë me optimiste se sa parashikimet nga ekspert te ndryshëm që po i dëgjojmë" tha zëvendësministri Aliu.

Meqë është krizë globale, në Kosovë do të ndjehen pasojat ekonomike të vendeve të zhvilluara për shkak të remitencave të mërgatës sone. BPV nominale e Kosovës për vitin 2019 ishte 7 miliardë euro (sipas Bankës Qëndrore të Kosovës[20]) - ndër më të ultat në në rajon, me komponentë kryesore konsumin privat, kontributi i të cilit në rritje ekonomike për vitin 2019 është vlerësuar rreth 3.4 për qind. Remitencat vitin e e kaluar kapën shumën prej 850 milionë euro dhe kur kësaj i shtohet edhe vlera monetare e "turizmit të diasporës" efekti financiar në ekonominë e Kosovës rritet deri në diku rreth 1.5 miliardë euro apo afro 22 për qind e BPV-së. Përvoja me krizën financiare globale 2008 tregon që ajo kishte prekur remitencat në Kosovë me trend rënës për dy vite me radhë, andaj në skenarin më optimist presim përsëritje të një reflektimi të tillë negativ për vitin aktual dhe vitin pasues.

Rënia e të hyrave mund të zbutet përmes mobilizimit të resurseve që Qeveria ka në dispozicion. Vendet si Kosova me politikë monetare të kufizuar përveç kredive nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe atyre vendore nuk kanë opsion tjetër, andaj zgjidhjet duhet të kërkohen pikërisht në këto adresa.

Vlerësimet fillestare të Ministrisë së Financave për humbjet në ekonominë e Kosovës si pasojë e pandemisë me COVID-19 kapin shifra prej 500 milionë euro[21] dhe kjo bazohet në parashikimet se pandemia po i kushton çdo ditë shtetit të Kosovës rreth 6 milionë euro.

Pandemia e shkaktuar nga koronavirusi ka prekur të gjitha fushat ekonomike. Në Kosovë është zvogëluar importi i produkteve, që nënkupton se ka rënie të konsumit. Sipas të dhënave të Doganave të Kosovës, vetëm për muajin mars dhe prill të këtij viti, importi i produkteve ka shënuar rënie, mbi 139 milionë euro, kurse eksporti i mallrave nga Kosovë në vende tjera rënie prej mbi 3 milionë euro. Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikojnë të hyra buxhetore për 200 milionë euro më pak për këtë vit në Kosovë.

"Nga data 1 mars 2020 deri më 30 prill 2020 importi i produkteve nga shtetet tjera në Kosovë ka qenë mbi 441 milionë euro, nga mbi 580 milionë euro sa ka qenë në të

18 "Republic of Kosovo: Request for purchase under the rapid finance instruments", International Monetary Fund, Country Report No. 20/112, Prill 2020

19 "The Economic and Social Impact of COVID-19", Banka Botërore, Nr. 17, Prill 2020.

20 BQK: Ekonomia e Kosovës në një shikim https://bqk-kos.org/eag/sq

21 "Bislimi: Kosova humb rreth 6 milionë euro në ditë për shkak të pandemisë", Radio Evropa e Lirë, 5 maj 2020, https://www.evropaelire.org/a/30594156.html

njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kurse eksporti nga mbi 61 milionë euro sa ka qene në muajin mars dhe prill të vitit të kaluar, ka rënë në 58 milionë euro", ka thënë Adriatik Stavileci në një përgjigjje për Radion Evropa e Lirë.[22]

Ekspertët e ekonomisë vlerësojnë se pasojat negative ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19 kanë goditur të dyja anët e ekonomisë - ofertën dhe kërkesën[23]. Një pjesë e bizneseve goditet në anën e ofertës (reduktim në prodhim dhe mungesë në artikuj të rinj për tregun) e bizneset tjera në kërkesë apo rënie të konsumit për shkak të humbjeve të vendeve të punës dhe falimentimit të bizneseve. Goditjet e para nga kjo situatë më pas vazhdojnë në ekonomi përmes kanaleve të ndryshme manifestuese, që shpërfaqen te veprimtaritë afariste në formë të largimeve nga puna, falimentimeve (kur bizneset për shkak të brishtësisë financiare nuk mund të qëndrojnë për një periudhë kohore të caktuar me një rrjedhë negative të parasë), kredi joperformuese ne sektorin bankar (kur kompanitë huamarrëse nuk munden të shlyejnë me kohë këstet e kredisë), ndërprerje të zinxhirit furnizues (për shkak të mbylljes së kompanive furnitore), rritje të çmimeve të artikujve të caktuar (për shkak të rritjes së kërkesë.)[24].

Edhepse vlerësimi i mirëfilltë i dëmeve të shaktuar do të kërkonte studim të hollësishëm në të ardhmen, sektorët më të afektuar në Kosovë duket të jenë ndërtimtaria, tregtia me pakicë, transporti, hotelieria me gastronomi, punëtorët e padeklaruar (të cilët kanë pësuar dyfish, së pari shkaku i mosdeklarimit para pandemisë nga punëdhënësit dhe tani nga humbja e vendit të punës) dhe të vetëpunësuarit (artistët, ekonomitë e vogla familjare, qiradhënësit etj). Gjatë periudhave të krizave, prirja e qytetarëve për kursim e rrit presionin e përgjithshëm mbi prodhuesit, e cila ulë ofertën duke shtyer investimet dhe duke zvogëluar më tutje kërkesën. Në këtë mënyrë ekonomia botërore futet në rreth vicioz.

Nga diskutimet e fundit të ekonomistëve, paradoksalisht vendet me shifra të larta të papunësisë do t'i kenë më të vogla pasojat në rënien e të hyrave në krahasim me vendet me shifrat papunësie më të ulëta. Kosova ka një problem të madh të punësimit joformal i cili, sipas një studimi të Bankës Botërore të vitit 2017[25], vlerësohet në rreth 100,000 punonjës krahasur me 340,000 të punësuar formalë. Në rast të tilla bëhet e vështirë edhe për Qeverinë të intervenojë me ndihma sepse lipset paraprakisht formalizimi i punjonësve informalë në mënyrë që të kualifikohen për benefitet nga pakoja emergjente fiskale.

Skenaret më pesimiste parashohin vazhdimin dhe thellimin e krizës deri në fund të vitit, e që do të shkaktonte shtrëngim enorm të kapaciteteve financiare të Qeverisë për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave për ndihmë. Në këtë situatë do të kishim rënie të mëtejme të numrit të vendeve të punës, rënie të të hyrave, humbje të bonuseve të dakorduara e të premtuara dhe shtyrje projektesh kapitale[26]. Në një skenar të tillë, bëhet e domosdoshme një qasje më pragmatike përmes rritjes së borxhit publik dhe huazimit të kredive më të mëdha nga institucionet ndërkombëtare financiare. Në mobilizimin e resurseve, përveç kredive dhe granteve ndërkombëtare, Bordi i Trustit Pensional mund të konsideronte që një pjesë të fondeve t'i financojë në letrat me vlerë të emetuara nga BQK-ja që janë të sigurta, por edhe në bankat komerciale vendore (në limitet që lejon ligji). Masa shtesë mund të ishin shtyrja e mëtutjeshme apo riprogramimi i kësteve të kredisë nga bankat komerciale, shtyrja apo riprogramimi i faturave për shërbime komunale, sidomos për familjet e varfra dhe ekonominë joformale.

Pasi që nuk dimë kohëzgjatjen e pandemisë dhe masave të rekomanduara nga IKSHPK-ja dhe të zbatuara nga Qeveria, nuk mund të dimë sa gjatë do të vazhdojë tkurrja ekonomike. Pasi që sektori privat përbën rreth 85 për qind të aktivitetit ekonomik në vend, do të jetë ai që do t'i bartë pasojat e mëdha. Është e vështirë të thuhet se sa kohë do të zgjasë këndellja ekonomike e sektorit privat, por bazuar në eksperiencat e kaluara të vendeve në zhvillim, Kosovës do të duhej të kthehej në shifrat e parapandemisë në prill apo maj të vitit 2021.

22 "Pandemia zvogëlon importin dhe eksportin në Kosovë", Zëri, 17 maj 2020

23 "Çollaku: Sektori privat do të plandoset nga efektet e pandemisë", Koha Ditore, 17 maj 2020

24 "Çollaku: Sektori privat do të plandoset nga efektet e pandemisë", Koha Ditore, 17 maj 2020

25 Cojocaru Alexandra, "Job Diagonistics Kosovo" World Bank Group, 2017
http://documents.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/ACS21442-WP-PUBLIC-ADD-SERIES-KosovoJDWEB.pdf

26 Intervistë me Pëllumb Çollakun, Koha Ditore, 16 maj 2020

PAKOJA PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

Ministria e Financave dhe Transfereve ka filluar tanimë punën rreth Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike Një grup punues nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Zyrës se Kryeministrit, Ministrisë se Bujqësisë, Bankës Qendrore të Kosovës, Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive, asociacioneve të bizneseve dhe ekspertëve të pavarur po dizajnojë elementet e pakos. Sipas MFT-së pakoja do ta ketë vëllimin e tërësishëm të mundësive prej mbi një miliard eurosh dhe pjesa dërmuese e saj do të jetë në formë të kredive me kushte të volitshme që ofrohet nga sistemi bankar. Qeveria do të garantoj ato duke marrë përsipër normën e interesit. Injeksioni prej një miliard eurosh do të mbulohet përmes një programimi nga shteti që kap shumën prej 300 milion euro, për arsye se pjesa tjetër mbulohet nga sistemi bankar. Qeveria e Kosovës tanimë ka aplikuar për kredi në disa institucione ne Bankën Botërore, në Fondin Monetar Ndërkombëtar, 50 milionë euro letra më vlerë i janë shitur Trustit Pensional të Kosovës, nga Bashkimi Evropian janë pranuar mbi 100 milionë euro që do të alokohen kryekëput për mbulimin e nevojave të Pakos se rimëkëmbjes. Njëkohësisht edhe 100 milionë euro nga projektet kapitale do të mjaftojnë për ndërtimin e pakos së rimëkëmbjes ekonomike.

Tabela në vijim paraqet disa nga burimet e financimit të pakos për rimëkëmje ekonomike:

Financimi i pakos për rimëkëmbje ekonomike

Emetimi i letrave me vlerë	**130,000,000.00**
Kreditimi i jashtëm me kushte të volitshme	**285,000,000.00**
FMN	52,000,000.00
Banka Botërore	22,000,000.00
Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës	35,000,000.00
Banka Botërore	46,000,000.00
BE Asistencë Makrofiskale	100,000,000.00
BERZH	30,000,000.00
Grantet e donatorëve	**30,500,000.00**
Riprogramimi i IPA-s	26,500,000.00
Banka Botërore për shëndetësi	2,000,000.00
WBIF (FLOWS)	1,000,000.00
CEB	1,000,000.00
Ulja e shpenzimeve buxhetore	**160,000,000.00**
TOTAL	**605,500,000.00**

TABELA 7 Burimet e financimit të pakos për rimëkëmbje ekonomike

Pakoja e rimëkëmbjes ekonomike do të duhej t'i siguronte stimulim të hovshëm edhe sektorit të bujqësisë, mendon ekonomisti Çollaku, pasi që periudha në të cilin ndodhemi do të na ndihmonte që produktet e importuara t'i zëvendësojmë me sa më shumë prodhim vendor. Kjo do të krijonte një ambient të favorshëm për mbështetje të rritjes së zingjirit të vlerës dhe të furnizimit në industrinë ushqimore brenda Kosovës, duke mundësuar kështu edhe rritjen e vlerës së shtuar në ekonomi, e cila do të garantonte më shumë të hyra nga tatimet. Një skemë e posaçme e garantimit të kredive për bujqësi, në mbështetje të atyre që u thanë më lart do të ishte shumë e dobishme.

Një qasje edhe më proaktive mes Qeverisë dhe Fondit për Garanci Kreditore, në shuma më të konsiderueshme dhe kuptimplote për NVM-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) sesa ajo e dakordimit të parë (p.sh. Serbia në mesin e masave të saj ka krijuar një skemë të tillë garantimi të kredive për NVM në vlerë prej 2 miliardë eurosh, ku 70 për qind të kredive garanton Qeveria). Subvencionimi dhe stimulimi i turizmit vendor gjithashtu do të duhej të ishin prioritet - gjatë kësaj vere do të ishte e shkëlqyeshme nëse një pjesë e pushimeve bëhet brenda Kosovës në mënyrë që paraja të ngelet sa më shumë brenda dhe të rritet koeficienti i multiplikimit të saj që do të rriste të hyrat nga tatimi.

Përveç masave të rimëkëmbjes, është mirë të vazhdohen edhe masat tjera të mirëmbajtjes së ekonomisë (marrëveshja me banka komerciale për lehtësira të shtyrjes së kësteve të kredisë për një kohë më të gjatë, mundësi riprogramimi të kredive, mbështetje rreth pagesës së faturave me kompanitë publike për shërbime komunalish etj.). Të dyja këto qasje do të duhej të ishin në funksion të parandalimit, mirëmbajtjes, rimëkëmbjes dhe zhvillimit të aktiviteteve ekonomike në këtë periudhë dhe në të ardhmen e afërm (gjatë gjithë vitit aktual).

Masa ndihmëse janë premtuar edhe për bizneset e reja, bujqit dhe firmat eksportuese. Për të rritur fuqinë blerëse, ndihmë do t'u ofrohet edhe amvisërive, sepse krahas mbështetjes për prodhimin në të njëjtën kohë duhet të rritet fuqia blerëse. Kjo mund të arrihet përmes ofrimit të kredive për dy vite, më një normë të interesit shumë të ulët.

Tabela në vijim paraqet disa nga masat e parapara me draftin aktual të pakos për rimëkëmje ekonomike:

Masat e pakos për rimëkëmbje ekonomike

MASAT E PAKOS PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE		BUXHETI I PLANIFIKUAR
Masa 1	Kreditimi i ekonomisë me synim rritjen e ofertës agregate	1.100.000.000 €
Masa 2	Grante për projekte inovative dhe kompani që angazhojne rininë	38.000.000 €
Masa 3	Rritja e punësimit përmes luftimit të informalitetit	27.000.000 €
Masa 4	Subvencionimi i pagave në sektorin e hotelierisë	12.000.000 €
Masa 5	Përmirësimi i sistemit arsimor dhe përshtatja me nevojat e tregut të punës	18.000.000€
Masa 6	Skemat e ndihmës sociale	34.000.000 €
Masa 7	Mbështetje për OJQ-të	3.000.000 €
Masa 8	Mbushja e rezervave shtetërore me mallra esenciale	20.000.000 €
Buxheti total		**1.252.000.000 €**

TABELA 8 Masat e pakos për rimëkëmbje ekonomike

Nora Hasani, drejtoreshë në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare, mendon se përfshirja e një agjende të gjelbër në rimëkëmbjen ekonomike, do t'i mundësoj Kosovës të përmbushë objektivat e saj për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme[27]. "Kjo do të krijonte më shumë vende të reja pune, siç bëri Gjermania gjatë "Energiewende" vazhdon Hasani. Sektor tjerë me potencial janë edhe ai i teknologjisë informative, që do të mund të çonte tutje digjitalizimin e sektorit publik dhe privat. Mundësi tjetër të mirë, ekonomistët i shohin edhe përpjekjet e shumë korporatave evropiane që për shkak të situatës me pandeminë po zhvendosin linjat e tyre të prodhimit nga Azia në drejtim të shteteve evropiane.

27 Nora Hasani, "Rimëkëmbje apo kolaps ekonomik, çfarë do të thonë historianët për ne?" https://ekonomiaonline.com/opinione/rimekembje-apo-kolaps-ekonomik-cfare-do-te-thone-historianet-per-ne/?fbclid=IwAR2NzpwKNwnz2_t2rPxNxVSY3xiyMGYiH38zfYsJwZYwoYPC-1YrEkG2nds

KDI-ja është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni **www.kdi-kosova.org**